



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9.3.2023

Nr: 155

Ora: 10:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE "BINDJA DEMOKRATIKE", PËR REGJISTRIMIN SI  
SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Sot më datë, 9.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1313 Prot., datë 3.3.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike "Bindja Demokratike", me kryetar z. Astrit Patozi.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike "Bindja Demokratike" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia "Bindja Demokratike", ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 9.3.2023 Nr: 155  
Ora: 10:00



"Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Bindja Demokratike", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 24.2.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Bindja Demokratike”, me initiale “BD”, me kryetar të përkohshëm z. Astrit Patozi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Bindja Demokratike” me shkronja nistore “BD”, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Astrit Patozi, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Suzana Gina, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Bllok, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Fabian Topollari, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani” Bllok Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Bindja Demokratike”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, dokumentacioni i paraqitur nga “Bindja Demokratike”, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pranë KQZ-së, është depozituar kërkesa me nr. 1313/1 Prot., datë 6.3.2023, ku në hyrje të kërkesës rezulton kryetar z. Astrit Patozi dhe në përmbajtjen e saj rezulton se kryetar i partisë politike “Bindja Demokratike” është z. Fabian Topollari.

Neni 92/2, pika 2, e Kodit Zgjedhor, parashikon hapjen e llogarisë së posaçme bankare nga subjekti zgjedhor sipas modelit të miratuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023. Rezulton se ky model është depozituar në KQZ, por është nënshkruar nga z. Fabian Topollari, për të cilin nuk ka autorizim nga kryetari i partisë për të kryer veprime në emër të partisë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e partisë politike “Bindja Demokratike”, me kryetar të përkohshëm z. Astrit Patozi, me shkronjat nistore “BD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**